

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS OPERACIONET

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2015

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË OPERACIONEVE	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-178

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Operacionet (FKPK-O), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar deri më 31 dhjetor 2015, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në mjetet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen korrekte të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është është që, bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës, të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të fitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të nevojshme për auditim, për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, këtu përfshihen dhe vlerësimi i rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Operacionet më 31 dhjetor 2015, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Operacionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014, janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur opinion të pakualifikuar për pasqyrat më 14 prill 2015.

Ky raport është përkthim i verzionit origjinal në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë verzioni në gjuhën angleze.

Prishtinë, Kosovë
12 prill 2016

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Mjetet			
<i>Mjetet qarkulluese</i>			
Paraja në dorë dhe në bankë	4	374,974	1,293,109
Investimet që mbahen deri në maturim	5	4,925,174	4,897,475
Llogaritë e arkëtueshme	6	615,766	406,516
Shpenzimet e parapaguara		40,448	20,479
		5,956,362	6,617,579
<i>Mjetet joqarkulluese</i>			
Pronat, impiantet dhe pajisjet	7	91,180	146,182
Mjetet e patrupëzuara	8	123,752	193,236
		214,932	339,418
Gjithsej mjetet		6,171,294	6,956,997
Detyrimet			
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Llogaritë e pagueshme	9	931,480	870,638
		931,480	870,638
Mjetet neto që iu takojnë FKPK - Operacioneve		5,239,814	6,086,359

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK dhe nënshkruar në emrin e tyre më 12 prill 2016.

Prof. Dr. Ymer Havolli
Kryesues i Bordit Drejtues

Z. Adrian Zalli
Drejtore Menaxhues

Z. Vërshim Hatipi
Zëvendësdrejtore për Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Të hyrat			
Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	11	5,819,478	5,269,319
Të hyrat nga mjetet e tjera	12	114,233	273,510
Gjithsej të hyrat		5,933,711	5,542,829
Shpenzimet			
<i>Shpenzimet e investimeve</i>			
Tarifat neto të instrumenteve për investime të hapura	13	(4,423,748)	(3,039,313)
Tarifat e BQK-së për transfere dhe mirëmbajtje		(9,138)	(53,244)
Brokerët, kujdestarët dhe shpenzimet për garanci		(9,887)	(11,487)
		(4,442,773)	(3,104,044)
<i>Shpenzimet Administrative</i>			
Kostoja e stafit	14	(574,068)	(521,541)
Shpenzimet për Bordin Drejtues	15	(157,403)	(177,863)
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondenca		(170,387)	(300,707)
Shpenzimet për operim të zyrës		(82,664)	(82,631)
Edukimi publik dhe shpalljet		(41,479)	(33,824)
Mirëmbajtja e softuerit		(44,812)	(54,525)
Tarifa e BQK-së për mbikëqyrje		(6,606)	(7,755)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7-8	(151,399)	(144,257)
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	16	(8,583)	(9,952)
Auditimi i jashtëm		(9,900)	(9,900)
Rimëkëmbja nga fatkeqësitë - qiratë dhe shpenzime të ndërlidhura		(6,650)	(17,177)
Takimet dhe konferencat		(1,791)	(937)
Komunikimi		(8,705)	(11,662)
Tarifat e shërbimeve bankare		(8,141)	(8,440)
Shpenzimet e tjera		(9,895)	(16,135)
		(1,282,483)	(1,397,306)
Gjithsej shpenzimet		(5,725,256)	(4,501,350)
Suficiti neto për vitin		208,455	1,041,479

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 177 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Suficiti	Rezervat	Gjithsej
		EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2014		47,380	5,000,000	5,047,380
Suficiti neto për vitin		1,041,479	-	1,041,479
Donacionet		(2,500)	-	(2,500)
Më 31 dhjetor 2014		1,086,359	5,000,000	6,086,359
Suficiti neto për vitin	10	208,455	-	208,455
Kthimi prej suficitit tek FKPK-MP		(1,055,000)	-	(1,055,000)
Më 31 dhjetor 2015		239,814	5,000,000	5,239,814

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
		EUR	EUR
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale			
Suficiti neto për vitin		208,455	1,041,479
<i>Rregullimet për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	7-8	151,399	144,257
		359,854	1,185,736
<i>Ndryshimet në mjetet dhe detyrimet operacionale:</i>			
Rritja në llogaritë e pagueshme/akruale		60,842	241,096
(Rritja) në llogaritë e arkëtueshme/parapagimet		(229,219)	(31,471)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale		191,477	1,395,361
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve		(22,564)	(58,624)
Blerja e softuerëve dhe licencave		(4,349)	(31,794)
(Rritja) në investimet që mbahen deri në maturim		(27,699)	(897,475)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese		(54,612)	(987,893)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Kthimi i suficitit në FKPK-MP		(1,055,000)	-
Donacionet		-	(2,500)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese		(1,055,000)	(2,500)
(Zvogëlimi) / rritja në paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj		(918,135)	404,968
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		1,293,109	888,141
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	374,974	1,293,109

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplimentuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të asetëve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK, në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Një anëtar pa të drejtë vote i përfaqëson interesat e Qeverisë.

Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm i menaxhuan operacionet ditore të FKPK-së gjatë vitit 2015 (2014: Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm).

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të FKPK-O janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-O i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare sipas konventës së kostos historike. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në euro, e cila është valuta funksionale dhe raportuese e FKPK-O. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshtatjes me prezantimin e vitit aktual.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

i) Standardet e reja dhe interpretimet në fuqi për periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Planet e përfitimit të definuara: Kontributet e punonjësve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2010-2012)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2011-2013)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014)

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka shkaktuar ndonjë ndryshim në politikat kontabël të FKPK-O.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (vazhdim)

Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

ii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më parë nga FKPK-O

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standarde të reja, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga FKPK-O.

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- **SNRF 14 "Llogaritë rregullatore të shtyrjes"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtori të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitetet e tjera" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Njësitë Ekonomike Investuese: Aplikimi përjashtim Consolidation (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 January 2016);
- **Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** - Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Iniciativa Disclosure (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme"** - Shpalosjet (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - njohjen e pasurive tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- **Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 38 "Pasuritë Jo-materiale"** - Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimi dhe amortizimi (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 41 "Bujqësia"** - Bujqësi: Bujqësi: bartës të bimëve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"**, - metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare individuale (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Fondi ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. FKPK- O parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Njohja e të hyrave

Tarifa është përllogaritur në baza ditore duke i ngarkuar me norma specifike bilancet ditore të bruto mjeteve pensionale.

Interesat nga depozitat bankare njihen në baza akruale.

3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet e operacioneve të FKPK-O përbëhen nga: Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme; mobilie, instalime dhe pajisje të ngjashme; pajisje të tjera të zyrës; dhe automjete; të cilët barten si kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimet nëse ka të tilla.

Zhvlerësimi ngarkohet në bazë të metodës drejtvizore përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të mjeteve, duke i përdorur normat si në vijim:

Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme -33%
Mobiliet, instalimet dhe pajisjet - 20%
Pajisjet e tjera të zyrës -20%
Veturat - 20%.

3.3 Mjetet e patrupëzuara

Mjetet e patrupëzuara përbëhen nga softuerët e licencuar kompjuterik. Këto fillimisht paraqiten sipas koston dhe më pas sipas koston së tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga prishjet, nëse ka të tilla.

Amortizimi regjistrohet kur këto mjete janë të disponueshme për përdorim sipas metodës drejtvizore ku kostoja e mjetit të patrupëzuar shlyhet përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit, duke i përdorur normat si në vijim:

Softuerët - 20%
Licencat amortizohen sipas kohëzgjatjes së licencës deri në maksimum 5 vjet.

3.4 Instrumentet financiare

Mjetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë: investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si mjete ose detyrime në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra ose shpenzime. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-O ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë, qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një mjet dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

3.5 Dëmtimi i aseteve jo-financiare

Vlera bartëse e aseteve jo-financiare rishikohet për dëmtime kur ngjarjet ndryshojnë ose në rast se ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera bartëse nuk është e rikuperueshme. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla, dhe aty ku vlera bartëse e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar, mjetet regjistrohen në shumën e tyre të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e pajisjeve të tilla është më e madhja në mes të çmimit neto të shitjes dhe vlerës përdoruese.

Në vlerësimin e vlerës përdoruese, rrijedhat e ardhshme të parashikuara të parasë zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para-tatimore, e cila e reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqeve përkatëse për mjetet.

Humbjet nga dëmtimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Investimet

Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit. Data e tregtimit është data kur FKPK-ja zotohet për blerjen apo shitjen e mjetit.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim përfaqësohen nga depozitat dhe investimet me pagesa fikse ose të paracaktuara, si dhe maturitetet fikse, të cilat FKPK-O ka qëllim pozitiv, por edhe mundësinë, **për t'i mbajtur deri në maturim. Depozitat me afat original të maturimit prej tre muaj ose më pak klasifikohen si ekuivalente të parasë së gatshme për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë, ndërsa ato me afat maturimi më të gjatë se tre muaj klasifikohen si investime të mbajtura deri në maturim.**

Interesi përlllogarit në baza akruale dhe interesi i arkëtueshëm reflektohet në të arkëtueshme tjera. Fletobligacionet e Qeverive ose Thesareve në kohën e përvetësimit vlerësohen sipas vlerave të tyre të diskontuara, ndërkohë që vlerësimet pasuese bëhen në vlerat e amortizuara të tyre.

Investimet e disponueshme për shitje

Mjetet e FKPK-O të investuara në fondet e përbashkëta për investime të hapura janë të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Këto investime fillimisht njihen sipas kostos, që është vlera e drejtë e shumës së dhënë përfshirë kostot e blerjes që ndërlidhen me investimin.

Pas njohjes fillestare, investimet në fondet e përbashkëta për investime të hapura rivlerësohen sipas vlerës së drejtë duke u bazuar në çmimet e kuotuar në mbyllje të tregtimit në datën e raportimit.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i renditë mjetet dhe detyrimet financiare në tri nivele, të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për mjete dhe detyrime identike;
- Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, mënjane nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e mjeteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe
- Niveli 3: shënimet hyrëse për mjetet dhe detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Në datat e raportimit, FKPK-O nuk ka pasur instrumente financiare që maten sipas vlerës së drejtë. Kjo për faktin se tepricat absolute të likuiditetit të FKPK-O investohen vetëm në depozita me afat ose në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës, duke bërë që ato të mos jenë të ekspozuara ndaj asnjë risku financiar me përjashtim të rrezikut nga falimentimi i vetë bankave me të cilat janë afatizuar depozitat ose shteti i Kosovës.

Dëmtimi i mjeteve

Dëmtimi i investimeve njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ka rënie të përhershme të vlerës së tyre.

3.7 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre ose më pak muajsh.

3.8 Tatimi

FKPK-ja si fond i mirëbesimit është i liruar nga tatimi në fitim i korporatave.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Kostoja e pensionit

FKPK-O nuk mban provizione e as nuk ka kurrfarë obligimi ndaj pensioneve të të punësuarve, përtej kontributeve të paguara në skemën e lartpërmendur të pensioneve.

3.10 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe periudhat e ardhshme që mund të ndikohen. Informacionet mbi sferat materiale me pasiguri të madhe të vlerësimit, dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në vijim:

Jeta e dobishme e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit

Menaxhmenti e ka rishikuar jetëgjatësinë e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit më 31 dhjetor 2015. Menaxhmenti ka vlerësuar se jetëgjatësia e pasurive përfaqëson dobishmërinë e pritshme të tyre. Vlerat bartëse të pasurive të tilla janë analizuar në Shënimet 7 dhe 8. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërsimit teknologjik.

3.11 Menaxhimi i riskut financiar

3.11.1 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-O nëse klienti ose pala tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale, dhe paraqitet kryesisht nga depozitat e FKPK-O në banka, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, dhe investimet në instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës.

3.11.2 Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, qasjen në fonde përmes mekanizmave adekuatë për kredi, si dhe aftësisë për të arkëtuar në kohë - sipas kushteve të paracaktuara - shumat e pritshme nga palët e treta. Tabela në vijim paraqet maturimet e mbetura kontraktuale të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPK-O. Tabela është përpiluar në bazë të rrjedhjes së pazbritur të parasë.

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Afatshkurtër Deri në 1 vit	Afatgjatë Mbi 1 vit	Afatshkurtër Deri në 1 vit	Afatgjatë Mbi 1 vit
	EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare				
Paraja në dorë dhe në bankë	374,974	-	1,293,109	-
Investimet që mbahen deri në maturim	4,925,174	-	4,897,475	-
Llogaritë e arkëtueshme	615,766	-	406,516	-
	5,915,914	-	6,597,100	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme	931,480	-	870,638	-
	931,480	-	870,638	-
Hendeku i maturimit	4,984,434	-	5,726,462	-

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.11.3 Risku i tregjeve

Risku i tregjeve vjen nga ndryshimet në çmimet e tregjeve, për shembull normat e këmbimit valutor dhe normat e interesit do të ndikojnë të hyrat e FKPK-O ose vlerën e instrumenteve financiare në posedim të tij. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregjeve është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregjeve përbrenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimet.

Risku i këmbimit valutor

Mjetet dhe detyrimet e FKPK-O nuk janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve në normat e këmbimit valutor meqë të gjitha transaksionet dhe bilancet janë në valutën vendore.

Risku i normave të interesit

Risku i normave të interesit vjen nga vlera reale ose vlera e rrjedhave të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Menaxhmenti i FKPK-O kryesisht është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit neto të riskut të normave të interesit, dhe vendos kufijtë për të reduktuar potencialin e mospërputhjes së normave të interesit. FKPK-O nuk kishte mjetet që bartnin interes variabil, ose mjetet e huazuara nga institucionet financiare vendore a të huaja në datën e pozicionit financiar.

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR

Që bartin interes

Normë fikse

Investimet që mbahen deri në maturim	4,925,174	-	4,897,475	-
Gjithsej	4,925,174	-	4,897,475	-

3.11.4 Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato mjete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Vlera bartëse	Vlera reale	Vlera bartëse	Vlera reale
	EUR	EUR	EUR	EUR

Mjetet financiare

Paraja në dorë dhe në bankë	374,974	374,974	1,293,109	1,293,109
Investimet që mbahen deri në maturim	4,925,174	4,926,185	4,897,475	4,897,475
Llogaritë e arkëtueshme	615,766	615,766	406,516	406,516
	5,915,914	5,916,925	6,597,100	6,597,100

Detyrimet financiare

Llogaritë e pagueshme	931,480	931,480	870,638	870,638
	931,480	931,480	870,638	870,638

4 PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Raiffeisen Bank Kosovo – Llogari rrjedhëse	31,420	1,029,350
ProCredit Bank - Llogari rrjedhëse	342,955	134,279
NLB Prishtina - Llogari rrjedhëse	257	125,657
Raiffeisen Bank International (Austria) - Llogari rrjedhëse	-	3,414
Paraja në dorë	342	409
Gjithsej paraja në dorë dhe në bankë	374,974	1,293,109

5 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM

	2015	2014
	EUR	EUR
Më 1 janar	4,897,475	-
Plasmanet		
KV1105640563 T-Bill Mat. 09.12.2015 @2.20%	-	4,891,198
KV1107540754 T-Bill Mat. 07.12.2016 @1.60%	4,920,399	-
	4,920,399	4,891,198
Interesi		
KV1105640563 T-Bill Mat. 09.12.2015 @2.20%	102,525	6,277
KV1107540754 T-Bill Mat. 07.12.2016 @1.60%	4,775	-
	107,300	6,277
Tërheqjet (me rastin e maturimit)		
KV1105640563 T-Bill Mat. 09.12.2015 @2.20%	(5,000,000)	-
	(5,000,000)	-
Më 31 dhjetor	4,925,174	4,897,475

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2015, investimet e FKPK-O që mbahen deri në maturim përbënin vetëm nga fletobligacionet e thesarit të Kosovës, të cilat ende nuk kanë rejting, dhe të cilat kishin afat original të maturimit prej më pak se 1 vit. Bilanci i investimeve të tilla në datën e raportimit ishte 4,925,174 euro dhe është qëllim i Bordit Drejtues që t'i mbajë deri në maturim.

6 LLOGARITË E ARKËTUESHME

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Të arkëtueshmet nga FKPK-MP	277,050	366,825
Rabatet e arkëtueshme nga fonde për investime të hapura	338,716	37,965
Të arkëtueshmet e tjera	-	1,726
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	615,766	406,516

Më 31 dhjetor 2015 vlera e të arkëtueshmeve nga FKPK-MP në shumë 277,050 euro (2014: 366,825 euro) ka të bëjë me tarifën e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve në shumë 237,612 euro dhe rabatet e ri-investuara në vlerë 38,987 euro (2014: 319,203 euro dhe përkatësisht zero euro), si dhe diferencat nga refondimet e kontributeve të gabuara në shumë 451 euro (2014: 47,622 euro), të cilat nuk u arkëtuan deri në datën e raportimit.

7 PRONAT, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme	Mobillet Installimet dhe pajisjet	Pajisjet e tjera të zyrës	Veturat	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR

Kostoja

Më 1 janar 2014	242,842	20,716	48,436	53,365	365,359
Shtesat gjatë vitit	39,059	-	19,565	-	58,624
Hudhjet gjatë vitit	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	281,901	20,716	68,001	53,365	423,983
Shtesat gjatë vitit	15,083	2,196	5,285	-	22,564
Hudhjet gjatë vitit	(10,104)	(1,042)	(2,355)	-	(13,501)
Më 31 dhjetor 2015	286,880	21,870	70,931	53,365	433,046

Zhvlerësimi i akumuluar

Më 1 janar 2014	(115,171)	(18,322)	(27,365)	(44,935)	(205,793)
Ngarkesa gjatë vitit	(59,490)	(931)	(6,989)	(4,598)	(72,008)
Të eliminuara me hudhjet	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	(174,661)	(19,253)	(34,354)	(49,533)	(277,801)
Ngarkesa gjatë vitit	(63,008)	(507)	(10,219)	(3,832)	(77,566)
Të eliminuara me hudhjet	10,104	1,042	2,355	-	13,501
Më 31 dhjetor 2015	(227,565)	(18,718)	(42,218)	(53,365)	(341,866)

Vlera neto në libra

Më 31 dhjetor 2015	59,315	3,152	28,713	-	91,180
Më 31 dhjetor 2014	107,240	1,463	33,647	3,832	146,182

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, nuk kishte peng mbi asetet e FKPK-O.

8 MJETET E PATRUPËZUARA

	Softuerët dhe Licencat
	EUR
Kostoja	
Më 1 janar 2014	339,798
Shtesat gjatë vitit	31,794
Hudhjet gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2014	371,592
Shtesat gjatë vitit	4,349
Hudhjet gjatë vitit	(3,110)
Më 31 dhjetor 2015	372,831
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2014	(106,107)
Ngarkesa gjatë vitit	(72,249)
Të eliminuara prej hudhjeve	-
Më 31 dhjetor 2014	(178,356)
Ngarkesa gjatë vitit	(73,833)
Të eliminuara prej hudhjeve	3,110
Më 31 dhjetor 2015	(249,079)
Vlera neto në libra	
Më 31 dhjetor 2015	123,752
Më 31 dhjetor 2014	193,236

9. ACCOUNTS PAYABLE

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Të pagueshmet për aktivitetet investuese	716,681	675,289
Detyrime të përlllogaritura për shtypjen dhe dërgesat e llogarive individuale	146,598	147,553
Të pagueshmet tjera	68,201	47,796
Gjithsej të pagueshme	931,480	870,638

Më 31 dhjetor 2015 bilanci i të pagueshme për aktivitetet investuese përfshirë tarifat e menaxhimit të faturuara nga drejtuesit e investimeve të hapura në vlerë prej 715,938 euro, si dhe brokerimit dhe të kujdestarisë së taksave në vlerë prej 743 euro (2014: euro 673,837 dhe 1,452 euro, respektivisht).

10 SUFICITI

	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
Të hyrat për vitin 2015			
Të hyrat nga tarifat e ngarkuara	1,101,069	4,718,409	5,819,478
Të hyrat jo-tarifore	112,824	1,409	114,233
	1,213,893	4,719,818	5,933,711
Shpenzimet për vitin 2015	(1,282,483)	(4,442,773)	(5,725,256)
Suficiti / (Deficiti) për vitin 2015	(68,590)	277,045	208,455
Suficiti në fillim të vitit	204,600	881,759	1,086,359
Kthimi i suficitit tek FKPK-MP	-	(1,055,000)	(1,055,000)
Suficiti në fund të vitit	136,010	103,804	239,814

Gjatë vitit 2015 **Bordi Drejtues vendosi t'i kthejë** 1,055,000 euro tek mjetet pensionale të kontribuuesve (FKPK-MP) nga suficiti i aktiviteve investuese, gjë që la bilanc të suficitit neto prej 239,814 euro më 31 dhjetor 2015.

11 TARIFAT E NGARKUARA NDAJ MJETEVE PENSIONALE

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet investuese	4,718,409	3,976,844
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet operacionale	1,101,069	1,292,475
Gjithsej tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	5,819,478	5,269,319

Tarifat për llogariten në baza ditore sipas formulës:

Tarifa = [Mjetet bruto të pjesëmarrësve] * [Norma] / [Numri i ditëve kalendarike në vit].

Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve për qëllime të financimit të aktiviteve të FKPK-O për fundvitin 31 dhjetor 2015 ishin në shumën 5,819,478 euro (2014: 5,269,319 euro).

Për vitin e përmbyllur më 31 dhjetor 2015, tarifat vjetore të ngarkuara në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168 ishin: a) nga 1 janari 2015 deri më 12 mars 2015: 0.400% për aktivitetet investuese dhe 0.130% për aktivitetet operacionale; b) nga 13 marsi 2015 deri më 31 dhjetor 2015: 0.400% për aktivitetet investuese dhe 0.085% për aktivitetet operacionale. Tarifat i miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

12 TË HYRAT NGA MJETET E TJERA

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Të hyrat nga interesi i investimeve që mbahen deri në maturim	107,300	93,892
Diferenca nga refondimet e kontributeve të gabuara	5,144	164,733
Të hyrat e tjera nga aktivitetet operacionale	380	5,926
Të hyrat e tjera nga aktivitetet investuese	1,409	8,959
Gjithsej të hyrat nga mjetet tjera	114,233	273,510

13 TARIFAT NETO TË INSTRUMENTEVE PËR INVESTIME TË HAPURA

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015			Për fundvitin 31 dhjetor 2014		
	Tarifa bruto	Rabati	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabati	Tarifa neto
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard - GSIF	884,512	(424,566)	459,946	813,537	(390,498)	423,039
BNY Mellon - RRF	1,033,227	-	1,033,227	868,854	-	868,854
AXA - GILB	357,110	(44,635)	312,475	246,174	(30,762)	215,412
Schroders - SISF	558,529	-	558,529	508,375	-	508,375
Aquila - RP7	143,518	-	143,518	231,565	-	231,565
ECM - DEC	-	-	-	101,033	-	101,033
Nordea 1 - GSEF	241,760	-	241,760	81,464	-	81,464
Nordea 1 - SRF	676,803	-	676,803	232,940	-	232,940
KBI - IDPDEF	431,497	(19,186)	412,311	152,493	-	152,493
AXA - WFOI	154,565	-	154,565	61,130	-	61,130
Pictet - HDS	209,272	-	209,272	76,744	-	76,744
Tobam - ABWEF	515,590	(294,248)	221,342	86,264	-	86,264
Gjithsej tarifat neto të instrumenteve të hapura	5,206,383	(782,635)	4,423,748	3,460,573	(421,260)	3,039,313

14 KOSTOJA E STAFIT

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Pagat e stafit	418,946	404,895
Kostoja e Kontratës Kolektive	32,811	-
Puna jashtë orarit, bonuset, tarifat e mbajtjes	46,830	46,109
Kontributet pensionale të punëdhënësit	46,340	42,984
Trajnimi i punonjësve	8,219	4,613
Sigurimi shëndetësor	7,363	7,930
Udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit	13,559	15,010
Gjithsej kostoja e stafit	574,068	521,541

15 SHPENZIMET PËR BORDIN DREJTUES

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Kompensimi për anëtarët	84,153	99,799
Sigurimi fiduciar	38,210	26,677
Takimet (udhëtimet/hotelet/kostot e tjera)	29,126	45,598
Kontributet pensionale të punëdhënësit	5,914	5,789
Gjithsej shpenzimet për Bordin Drejtues	157,403	177,863

16 SHËRBIMET PROFESIONALE/KONTRAKTORËT/KONSULENTËT

	Për fundvitin 31 dhjetor 2015	Për fundvitin 31 dhjetor 2014
	EUR	EUR
Shërbimet e dizajnit	5,759	6,001
Shërbimet e përkthimit dhe korrigjimit	2,649	3,742
Shërbimet e noterëve/ligjore	175	209
Gjithsej shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	8,583	9,952

17 NGJARJET PAS PERIUdhËS SË RAPORTIMIT

Për dy muajt e parë të vitit 2016, FKPK-O i ka këto të dhëna financiare të bazuara në pasqyrat e paaudituar financiare për këta dy muajt.

	Më 29 shkurt 2016
	EUR
Gjithsej mjetet	5,950,236
Detyrimet qarkulluese	(642,750)
Mjetet neto të Operacioneve	5,307,486

	Për perludhën 1 Janar - 29 shkurt 2016
	EUR
Gjithsej të hyra	970,301
Gjithsej shpenzime	(902,629)
Suficiti neto	67,672

Nuk ka ngjarje të tjera të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalesje të mëtejshme në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.

